



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DRAFTË - RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUSË TË ZONIMIT PËR
KOMUNËN E KLINËS

Klinë, 2023

Në bazë të neneve 62.3 ndërlidhur me nenet 11,12.2 shkronja c) 40.2 shkronja a) dhe neni 17 shkronja b) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 16 i Ligjit 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, nenin 36 dhe 39 të Udhëzimit Administrativ MMPH 24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, neni 13 i Rregullores (MAPL) nr.02/202, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028 me nr. _____, si dhe dispozitave të Statutit të Komunës së Klinës, nr. _____ të datës _____/, kuvendi komunal i Klinës në seancën e rregullt me dt. _____/2023, miratoi:

PROJEKT - RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUSË TË ZONIMIT PËR KOMUNËN E KLINËS

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen bonuset e zonimit, përmes të cilave lejohen stimuj në emër të kompensimit për interes publik për lirim të sipërfaqeve për objektet dhe infrastrukturën publike.

Kjo Rregullore do të jetë në përputhje me qëllimet, objektivat, vizionin dhe strategjitë e PZHK-së, HZK-së dhe do të përdoret për të rritur hapësirat publike dhe sipërfaqet e gjelbëruara, ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizjeve të këmbësorëve, krijon sipërfaqe ku mund të zhvillohen projekte për ndërtimin e objekteve publike prej të cilave përfiton komuniteti.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i kësaj rregullore përcakton mënyrën e kompensimit të tokës së planifikuar për ndërtim në zonën e lejuar me bonuse të zonimit sipas HZK-së.
2. Procedurat e dhënies së bonusit, format e kompensimit janë të përshkruara si më poshtë:
 - 2.1. Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
 - 2.2. Zvogëlimi apo lirim nga taksat për leje ndërtimore;
 - 2.3. Zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi;
 - 2.4. Rritje të lartësisë dhe kateve-etazheve maksimale të ndërtesës nga ajo që është e planifikuar me HZK;
 - 2.5. Rritje të dendësisë ISN nga ajo që është e paraparë me HZK.

Neni 3 PËRKUFIZIMI

1. Fjalët apo shprehjet e tjera, të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim :
 - 1.1. **“Hapësirave publike dhe sociale”**- janë hapësira në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe privat si :

- 1.2 Parqe publike dhe hapësira të hapura, fusha sportive dhe hapësira rekreative, hapësira dhe ndërtimet për shërbime mjekësore, ndërtesat për shërbime sociale, ndërtesat e institucioneve parashkollore, shkollat dhe universitetet, qendrat administrative, hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike dhe hapësirat e hapura, hapësirat e gjelbëruara dhe parqet.
- 1.2. **“Infrastrukturë sociale”**- Shtrirja e hapësirave dhe ndërtesave për zhvillimin e veprimtarive arsimore, sportive dhe kulturore, bibliotekave, parqeve publike, qendrave të komuniteteve, institucione të komunikimit publik dhe të tjera të ngjashme.
- 1.3. **“Infrastrukturë publike”**- Shtrirja e ndërtesave për shpërndarjen dhe mbledhjen e postës, kujdesin shëndetësor, arsimimin, administratën publike dhe shërbime të tjera të ngjashme.
- 1.4. **“Bonuset e Zonimit”** –janë stimuj që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik në kuadër të normave teknike të planifikimit hapësinor.
- 1.5. **“Kompensimi”** -Nënkupton shpërblimin e drejtë sipas vlerës së tregut në momentin e njohjes së shpërblimit të kryer sipas kësaj rregullore.
- 1.6. **“Shpronësimi”**- Nënkupton çdo vepër të një organi shpronësues që përfshinë marrjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është në zotërim ose pronësi të një personi në një pronë të paluajtshme ose krijimin e detyrueshëm të një servituti ose një të drejtë tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme.
- 1.7. **“Pronë e Paluajtshme”**- Nënkupton tokën, ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuar mbi ose nën sipërfaqen e tokës si dhe pjesët përbërëse dhe sendet aksesore të cilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershëm dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme dhe jo ekonomike.
- 1.8. **“PZHK”**- Plani Zhvillimor Komunal, dokument i planifikimit hapësinor i nivelit lokal në pajtim me dispozitat e nenit 15 të ligjit për planifikim hapësinor Nr.04/L-174 .
- 1.9. **“HZK”**- Harta Zonale Komunale, dokument i planifikimit hapësinor i nivelit lokal në pajtim me dispozitat e nenit 16 të ligjit për planifikim hapësinor Nr.04/L-174 .
- 1.10. **“MMPHI”**- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- 1.11. **“Parcela Kadastrale”**
- 1.12. **“Komuna”**- Komuna e Klinës.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore mund të gjinden në Ligjin për planifikim hapësinor 04/L-174, Ligjin për ndërtim 04/L-110, Udhëzimin Administrativ 08/2017 MMPHI, Udhëzimin Administrativ 24/2015.

Neni 4 Bonuset e Zonimit

1. Bonuset e zonimit janë stimuj që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik, brenda normave teknike të planifikimit hapësinor, Hartës Zonale dhe të Planit Zhvillimor Komunal.
2. Bonuset e zonimit do të jepen duke respektuar kushtet zhvillimore dhe normat teknike sipas planifikimit hapësinor dhe përfshijnë si më poshtë:
 - 2.1 Zvogëlim, përcaktimin e vijave të ndërtimit;
 - 2.2 Zvogëlim apo lirim nga taksat për leje ose tarifatat për infrastrukturë;
 - 2.3 Zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës kadastrale, madhësi, gjerësi dhe thellësi;
 - 2.4 Rritja e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshme të shputës në raport me parcelën kadastrale ;
 - 2.5 Rritje të lartësisë dhe kateve maksimale, dhe gabaritit të ndërtesës dhe nga ajo e planifikuar me HZK
 - 2.6 Rritja e dendësisë ISN nga ajo e planifikuar me HZK.
 - 2.7 Distanca nga kufiri i parcelës me marveshje nga pika 0 me kusht pa hapje(lejohet ndriqimi i shkalleve dhe banjove),

Neni 5 Përcaktimi i Bonusit

- 5.1 Për të gjitha zonat e përcaktuara në të cilat mund të aplikohen bonuset e zonimit, sipërfaqja e parcelës kadastrale e cila kalon në pronësi komunale do të kompensohet me rritje të indeksit të sipërfaqes së përgjithshme ndërtuese.
 - 5.2 Raporti i bonusit të zonimit që jepet në këmbim të sipërfaqes së parcelës kadastrale e cila shpronësohet për interes të përgjithshëm publik i lejon aplikuesit-zhvilluesit rritjen e indeksit të sipërfaqes së përgjithshme ndërtuese në raport 1 me 1.25
P.sh.: Nëse komuna përfiton një sipërfaqe të parcelës kadastrale prej 100 m², zhvilluesi do të përfitojë bonus prej 125 m² sipërfaqe bruto ndërtuese banimore .
 - 5.3 BANIMI SOCIAL-njësi banesore që kalon në pronësi komunale nga investitori: Njësia e re banesore (objekte shumë-banesore të përfunduara) të fitohet në raport:
 - Kati i banimit nga etazhi 1 deri 3 të vlen raport 1m² me 2.5m² .
 - Kati i banimit nga etazhi 4 deri 6 të vlen raport 1m² me 2.0m² .
 - Kati i banimit nga etazhi 7 e lartë të vlen raport 1m² me 1.5m² .
- Përcaktimi i katit, orientimit të njësisë banesore dhe metrat katrorë (m²) caktohen nga komisioni i caktuar nga komuna e Klinës.
- 5.4. Koeficienti maksimal i lejuar për të gjitha blloqet ndërtimore (ZB1- ZB7,ZSH1-ZSH4,ZI1,ZK1-ZK4,ZSH1-ZSH12,ZrT,ZrT1-ZrT3,ZKT1-ZKT5,ZM1-ZM2,Zb,SU1-SU2,ZmaH,ZmS) me destinim të përzier dhe atë për banim kolektiv duke përfshirë edhe sipërfaqen e fituar me bonuse të zonimit mund të jetë 3.0-5.5
 - 5.5. Për blloqet të cilat pas aplikimit të bonuseve të zonimit, tejkalojnë vlerën e koeficientit maksimal të ndërtimit prej k=3.0-5.5, zhvilluesve u lejohet që të bëjnë bartjen e sipërfaqeve të mbetura në blloqe të tjera.

Neni 6

Lista e të gjitha llojeve dhe kategorive të përfitimeve të komunitetit që mund të pranohen nga zhvilluesit

1. Zhvillimi i zonës së planifikuar për ndërtim si dhe për aplikim të bonuseve të zonimit, realizohet me miratim nga organet kompetente komunale me anë të kësaj rregullore për realizimin e infrastrukturës publike, sociale, teknike, rrugore dhe të ngjashme si më poshtë :
 - a) Parqet publike dhe sipërfaqet e hapura;
 - b) Qendrat administrative;
 - c) Objekte shëndetësore dhe sociale;
 - d) Objekte shkollore;
 - e) Institucione parashkollore;
 - f) Përmbajtje rekreative sportive;
 - g) Parqe dhe rekreative;
 - h) Teatër;
 - i) Bibliotekë;
 - j) Kinema;
 - k) Objekte me destinim garazhesh mbitokësore;
 - l) Objekte me karakter fetar;
 - m) Infrastrukturë rrugore;
 - n) Varrezat.

Neni 7

Sipërfaqet dhe standardet për zhvillim të përfitimeve publike

1. Sipërfaqet për zhvillim të infrastrukturës publike do të përcaktohen sipas Udhëzimit Administrativ 08/2017 MMPHI dhe HZK komunës së Klinës 2020-2028.
2. Për blloqet ndërtimore sipas HZK, zhvillimi i infrastrukturës publike, sociale, teknike, rrugore dhe të ngjashme sipas nenit 6 të kësaj Rregullore që nuk e kanë saktë të specifikuar lokacionin, Komuna lidh marrëveshje me zhvilluesit përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme duke respektuar kushtet zhvillimore në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Neni 8

Përcaktimi i zonave ku mund të aplikohen bonuset e zonimit

1. Zonat në të cilat mund të aplikohen Bonuset e zonimit me qëllim të zhvillimit të infrastrukturës publike (**sipas nenit 6**) janë të përcaktuara me HZK me kodet përkatëse : (ZB1- ZB7,ZSHP1-ZSHP4,ZI1,ZK1-ZK4,ZSH1-ZSH12,ZrT,ZrT1-ZrT3,ZKT1-ZKT5,ZM1-ZM2,Zb,SU1-SU2,ZmaH,ZmS)
2. Zonat në të cilat mund të aplikohen bonuset e zonimit me qëllim të zhvillimit të infrastrukturës rrugore përfshijnë të gjitha blloqet sipas HZK (të gjitha zonat ato urbane dhe rurale).

Neni 9

Zbatimi i bonuseve në dobi të interesit publik

1. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale zhvillimore ISHPKZH-për të gjitha zonat me destinim të përzier, si dhe banim kolektiv (ZB1- ZB7,ZSH1-ZSH4,Z11,ZK1-ZK4,ZSH1-ZSH12,ZrT,ZrT1-ZrT3,ZKT1-ZKT5,ZM1-ZM2,Zb,SU1-SU2,ZmaH,ZmS) do të jetë 50%.-70%
2. Në të gjitha zonat, ndërtesat e banimit kolektiv, përmbajtjet afariste mund të projektohen në katin përdhese dhe në katin e parë.
3. Për sipërfaqet nëntokësore të parcelës (SNP-bodrumi), Vija ndërtimore nëntokësore nga ana fqinjësore (jo nga rruga publike) mund të jetë me distancë min.1m por niveli i dyshemesë bodrum-përdhese të ketë kuotën absolute 0,00m, ndërsa nga rruga publike ta ketë distancën min. me vijën rregullative.
4. Billoqet ndërtimore sipas HZK-së , në të cilat janë zhvillimet jo konforme me gjendjen ekzistuese mund të bëhet ridestinimi i zonës, zhvendosja e rrugëve sekondare ose heqja e tyre, me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit të tij.
5. Parcelat ndërtimore që kërkojnë shqyrtim e të cilat janë me sipërfaqe më të vogël se sipërfaqja e caktuar me norma të HZK, e që nuk mund të bëjë bashkëpunim me parcelat fqinje, shqyrtohet me të gjitha normat tjera.

Neni 10

Zbatimi i rregullores dhe marrëveshja për bonuse

1. Aplikimi për bonuset e zonimit bëhet në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e cila është e obliguar ta trajtojë kërkesën dhe rekomandojë propozimin tek kryetari i komunës.
2. Propozim për sipërfaqet e trajtuara me bonuse të zonimit e në mes të Komunës-Kryetarit të komunës dhe zhvilluesit-investitorit do të jetë publike dhe do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të komunës për pesë (5) ditë, (gjatë kësaj faze palët e interesuara kanë të drejtë të japin komente lidhur me këtë propozim marrëveshje).
3. Marrëveshja përfundimtare do të nënshkruhet pas kalimit të afatit pesë (5) ditor, në mes të Kryetarit të Komunës së Klinës dhe zhvilluesit-investitorit dhe do të ketë fuqi juridike ekzekutive dhe e cila do të shërbejë si bazë juridike për ndryshime kadastrale dhe regjistrim në regjistrat e pronës në emër të palëve pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
4. Pas përcaktimit të marrëveshjes, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, do ta zbatojë marrëveshjen në kuadër të kushteve dhe lejes ndërtimore që do të lëshohen për aplikuesin konform UA 06/2017.
5. Në rast të mosrespektimit të marrëveshjes apo shmangies nga qëllimi për të cilën është lidhur marrëveshja, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, do ta rekomandojë kryetarin e komunës për shkëputje të marrëveshjes.
6. Kryetari i komunës para se të merr vendim për shkëputjen e marrëveshjes, në mënyrë të njëanshme, paraprakisht, do ta informojë palën shtatë (7) ditë më parë për ndërprerjen e marrëveshjes.

7. Për implementim të kësaj Rregullore, përgjegjës do të jenë (*Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës*).

Neni 11 Procedurat e ankesave

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës, ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit.
2. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e formon komisionin për shqyrtimin e ankesave.
3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të përbëhet prej tre (3) anëtarëve të Drejtorisë përkatëse.
4. Komisioni për ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës.
5. Ndaj vendimit të komisionit pala mund të ushtrojë ankese në shkallën e dytë MMPHI.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Për të gjitha çështjet që nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, apo në rastet e kolizionit me ligjet apo aktet nënligjore vlejnë dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Komuna e Klinës, më: _____ / 2023.

Kryetari i Kuvendit Komunal

Fadil Gashi



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. _____ 2023

Klinë:

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 27. 01. 2023, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Anëtarët e Kuvendit të Komunës, kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e parë për vitin 2023 e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se prezent janë të gjithë anëtarët e kuvendit dhe se seanca mund të vazhdoj punimet. Fillimisht z. Gashi lexoj një kërkesë të drejtuar nga Shoqata-Qendra e Gjenocidit në Kosovë- plagë e hapur, drejtuar Kuvendit të Komunës . Kjo qendër kërkon mbështetje nga Kuvendi i Komunës së Klinës për zyrtarizmin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë. Në vazhdim kryesuesi z. Gashi e lexoj kërkesën e drejtuar për anëtarët e kuvendit të nënshkruar nga z. Bardhyl Mahmuti në emër të kësaj shoqate. Kërkesa e lexuar në tërësi kërkonte që simboli i Lulëkuqes me katër petale të përfaqësonte katër kategori: Vrasjet, dhunën seksuale, spastrimi etnik dhe shkatërrimi i objekteve gjatë luftës.

Kryesuesi ju propozoj një deklaratë mbështetëse dhe e lexoj deklaratën: Ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës e mbështesim unanimisht idenë që lulëkuqja të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë. Kuvendi i Komunës së Klinës e vlerëson se e ardhmja e popullit tonë të definohet edhe nga ndërtimi i memories kolektive, përkujtimi i viktimave nga e kaluara e jonë.

Kryesuesi hapi debat rreth kësaj deklarate dhe rreth kërkesës në fjalë.

z. Esat Raci, z. Valmir Bacaj, z. Arben Limanaj, z. Zafer Gashi në emër të grupeve të tyre kuvendare deklaruan se e mbështesin këtë deklaratë.

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA DEKLARATA.

Në vazhdim për rendin e ditës kryesuesi i kuvendit hapi debat.

z. Esat Raci: Nuk kam asgjë kundër rendit të ditës vetëm dëshiroj të pyes se a e kanë përfunduar punën komisionet e formuara nga kryetari i Komunës për vlerësimin e dëmeve të vërshimeve të ndodhura në Komunën tonë. Sa është dëmi i krijuar etj. Natyrisht edhe unë edhe grupi kuvendar i PDK-së solidarizohet me të gjithë të prekurit nga këto vërshime.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kam informacionin edhe nga kryetari edhe nga komisionet se këto komisione janë duke punuar në teren, ekzekutivi ka qenë në krye të detyrës me kapacitetet që i akne dhe në momentin që do ta kemi raportin e këtyre komisioneve ne do ta shqyrtojmë në kuvend.

Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe me 27 vota për u MIRATUA.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

U Konstatua se të gjithë anëtarët e kuvendit janë prezent në mbledhje.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit.

Kryesuesi theksoi se janë dy procesverbale . I seancës së rregullt dhe i asaj të jashtëzakonshme që është mbajtur brenda muajit. Gjithashtu theksoi se dëshiron që të bëjë një përmirësim në deklaratën e tij kur ka folur për raportin e kryetarit të komunës e që ka thënë gabimisht se raporti i kryetarit nuk debatohet e në fakt ka dashur të thotë se nuk votohet por që të debatohet po gjithsesi.

z. Zafer Gashi: Pikërisht për këtë deklaratë tënden ne e kemi braktisur këtë raport sepse menduam që s` ka debat. Po ashtu propozoj që të bëjmë dallimin në mes procesverbaleve pasi që në takim9n e kryetarit me qytetar nuk kishte fare debat as diskutime prandaj si rrjedhojë as procesverbal s` duhet të ketë.

Kryesuesi ndërhyri duke sqaruar se procesverbali i takimit të kryetarit me qytetarë është në pikën e 3 të rendit të ditës e jo në këtë pikë.

Më 26 vota për asnjë kundër u Miratuan të dy procesverbalet me ndryshimin e theksuar nga kryesuesi.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga takimi i kryetarit të Komunës me qytetarë.

Me 24 vota për , dy kundër, asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 4 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi theksoi se të gjitha rekomandimet e KPF-së janë në rend të ditës përveç një kërkesë që është adresuar në zyrën e kryetarit.

z. Zafer Gashi: Kam një kërkesë në emër të grupit të LVV. Nëse është e mundur që të kemi një raport nga viti i kaluar për personat që kanë kërkuar ndihmë për shërim. Do të donim që të kemi të dhëna se kujt janë ndarë ato mjete dhe sa kanë qenë. Kemi një rast për një bashkëluftëtar tonin,

Sokol Gashin, ku kërkesën e tij e kemi miratuar në KPF dhe ajo ndihmë nuk i ka shkuar akoma. Personi në fjalë e ka kaluar operacionin dhe fatbardhësisht është mirë me shëndet. Njëjtë edhe për komandimin e dëmeve nga hera e kaluar , ne kemi ndarë mjetet 86 mijë euro por ka persona që akoma nuk i akne marr ato mjete.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Përshëndetje të gjithëve. Bëhet fjalë për një rekomandim të KPF-së që ka ndodhur pas datës 12 dhjetor që ka qenë afati i fundit për zotim të subvencioneve dhe nuk ka mundur të kryhet në vitin e kaluar. Tani akoma nuk është hapë mundësia nga thesari. Në shkurt hapet thesari dhe sigurisht që do të realizohet ai rekomandim. Njëjtë edhe sa i përket pagesave nga subvencionet për kompensim të dëmeve. Kemi pasur disa probleme me gjiro llogari të të dëmtuarve. Nuk kanë pasur mundësi që të i kompletojnë dokumentacionet deri me datën 12 dhjetor dhe tani deri të bëhet hapja e thesarit do të na duhet që të presim dhe të shihnim a ka bazë ligjore për realizim. Raporti i njëjtë ka shkuar edhe në qeveri. Shpallja publike për kompensim sipas ligjit ka qenë 8 ditore.

z. Esat Raci: Edhe ne si grup dëshirojmë që rekomandimet të votohen në bllok. Një tjetër shqetësim yni është se është muaji i katërt që ne si grup i PDK-së jemi vetëm me një anëtar të KPF-së. Pse nuk është ftuar anëtari ynë i dyti në mbledhjet e KPF-së.

Kryesuesi theksoi se nuk ka pasur konfirmim të ligjshmërisë nga ministria në lidhje me këtë.

z. Valmir Bacaj: Ne si grup kuvendar pajtohem me rekomandimet e KPF-së.

Rekomandimet e KPF-së në bllok u votuam dhe me 26 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

Pika 5 e Rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit financiar janar- dhjetor 2022.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Meqenëse është seanca e parë e këtij viti unë ju uroj të gjithëve duke dëshiruar që të ju shkoj mbarë të gjithëve. Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2022 do të japim një pasqyrë të buxhetit , të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore , do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak . Raporti për periudhën janar-dhjetor 2022, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK , shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave . Buxheti për këtë periudhë ishte 12,681,824.11 €. Siç shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2022 është më i lartë për rreth 9 % se buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2021 . Grandi Qeveritar në vlerë 10,372,411.74 € është burimi kryesorë i financimit të buxhetit komunal , 81.79% e buxhetit total në këtë periudhë . Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 1.46 % më i lartë. Siç shihet edhe në tabelë buxheti nga THV të vitit 2022 është 1,065,865.00 € (8.40 % e buxhetit total në këtë periudhë) . Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i lartë për rreth 28.35% . Të hyrat e bartura janë 1,196,666.06 € (9.44 % e buxhetit total në këtë periudhë).Në raport me vitin paraprak janë më të larta për rreth 115.63 % . Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit ,si burim të financimit në këtë periudhë

kemi edhe donacionet siç janë : - Participimi i qytetarëve në vlerë 41,443.63 € (0.33 % e buxhetit total në këtë periudhë) , në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetar është rreth 95.38 % më i lartë se në vitin paraprak . Donacioni nga Save the Children është 5,437.68 €. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € është 91.07 % e buxhetit në SIMFK për vitin 2022. Nga Granti qeveritar 10,009,166.28 € (96.50 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 663,126.57 € (62.21 % në raport me buxhetin nga të hyrat 2021) , nga të hyrat e bartura 850,471.49 € (71.07 % në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura) , nga participimi i qytetarëve 21,361.50 € (51.54% në raport me buxhetin nga participimet me qytetar dhe nga Save the Children 5,437.68 €(100 % në raport me buxhetin nga ky donacion . Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 11,549,563.52 € nga granti qeveritar janë 86.66 % , nga të hyrat vetanake 5.74 % , nga të hyrat e bartura 7.36 % , nga participimi i qytetarëve 0.18 % dhe nga Save the Children 0.05% . Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 3.73 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,443,170.89 €, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,340,623.85 €, për shërbime komunale 166,971.64 € , për subvencione 401,428.90 € dhe për kapitale 3,197,368.34 €. Shpenzimet në periudhën janar- dhjetor 2022 në vlerë 11,549,563.52 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2021 në vlerë 11,134,681.61 € janë rritë për rreth 3.73 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogëluar rreth 3.84 % , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritë për rreth 10.66 % , shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për rreth 6.93 % , shpenzimet për subvencione janë rritë për 16.32 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritë për rreth 18.49 % . Komuna ka arkëtuar gjithsej 1,573,242.79 € të hyra , në periudhën janar – dhjetor 2022. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat janë më të ulta për 6.11 % ose në vlerë për 102,357.26 €. Në totalin e të hyrave për vitin 2022 , vlera 1,573,242.79 € nuk janë përfshi të hyrat e tremujorit të fundit për gjobat nga trafiku dhe dënimet nga gjykata.

Hapet debat rreth raportit financiar

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje të gjithëve. Ne kemi vërejtjet tona në lidhje me këtë raport. Ka shumë mangësi në këtë raport. Shpenzimet nuk janë specifikuar, janë shpenzime të bartura. Mendojmë që ky raport nuk ka transparencë dhe nuk ka realizim. Drejtori e tregoj vetëm shifrën përfundimtare e jo edhe detajet.

Në vazhdim z, Haliti u ndal tek një shqetësim sipas tij që është i madh , suficiti në vlera prej një milion e 132 mijë euro dhe sipas z. Haliti Klina ka shumë projekte që duhet të realizohen dhe mbetja prej më shumë se një milion euro është e keqe. Prandaj theksoi ai grupi kuvendar i PDK-së nuk do ta votoj këtë raport. Në vazhdim kishte vërejtje edhe tek të hyrat nga kurorëzimet duke i krahasuar me ato të vitit paraprak. Tek Mobilet dhe pajisjet, krahasuar me vitin 2021 është diferenca prej 14 mijë euro më e madhe , punëtorë me kontratë – jo në listën e pagave, pajisje të tjera, furnizime me artikuj bujqësor etj. të cilat krahasuar me vitin e kaluar ka s'përputhje të madhe, sipas z. Haliti.

Kryesuesi theksoi se ky raport nuk kërkohet që të aprovohet por vetëm të shqyrtohet.

Znj. Arta Pantina : Përshëndetje. Tek raporti financiar janë dhënë disa shuma për furnizime me pajisje speciale mjekësore(tregon shumë në mjete). Sipas informatave që kemi , furnizimi i QKMF-së në Klinë është në mungesë me barna esenciale. Qytetarët në mungesë të këtyre barnave detyrohen që të shkojnë në barnatore private. Pse nuk bëhet furnizimi i rregullt me këto barna esenciale QKMF-ja, ndërkohë që jepen shuma të tilla për pajisje speciale mjekësore?

z. Arben Limanaj: Pjesa më e madhe e materialit nuk më ka ardhur, kem pasur problem me e-mail zyrtar dhe skam pas mundësi me e lexuar raportin financiar. Ajo që lexova dua ta pyes drejtorin, tek kodi 11/400 punëtorët me kontratë- jo në listë të pagave. Behët fjalë për punëtorët me kontratë në vepër apo si?

z. Zafer Gashi: Tek pjesa e shpenzimeve buxhetore i kam të listuar ato që mendojmë që akne qenë shpenzime të tepërta. Sidomos kam shumë vërejtje tek punësimi pa kontratë. Po ashtu shpenzime ka rritje tek sektori i shëndetësisë. Unë llogaris se ka pasur nevojë në shërbimet shëndetësore, po ashtu tek furnizimi mjekësor, janë ble reagjentë për rengen që janë të kushtueshme. Kur jemi tek furnizimet me barna, duhet pasur kujdes se e shkelni ligjin ashtu siç ka dalur nëpër media. Gjithashtu ju tërheqim vërejtjen tek furnizimi me aparatura nga disa firma të cilat aparaturat ti japin falas por të detyrojnë që të furnizohesh me reagjentë nga firma e tyre pasi që ato aparatura nuk përbëjnë me reagjentë të tjerë, aty pastaj ata ta ngritin çmimin e reagjentëve. Në këtë rast QKMF-ja duhet të paguaj çmimin më të madh se sa është në treg. Më shqetëson edhe shpenzimet për mirëmbajtje, është një shumë e madhe. Është mirë që të shihet mundësia të zvogëlohen këto shpenzime ose të jenë më racionale.

z. Valmir Bacaj: Ne si grup kuvendar kemi analizuar këtë raport financiar dhe mund të konsiderohet plotësisht pozitiv duke u bazuar edhe në rritjen buxhetore për vitin 2022 prej 9%, të hyrat vetanake më të larta për 28.35%. Edhe kategoria tjetër e buxhetit , ajo e shpenzimeve konsiderohet pozitive sepse kemi një realizim të buxhetit prej 91.07% dhe për investime kapitale 78.93%. Duke e pasur parasysh vështirësitë që ka pasur vendi me inflacion, mungesa e funksionalizimit të gjykatave për tenderët përkatësisht organi shqyrtues i prokurimit ku janë bllokuar një pjesë e projekteve për shkak të ankesave të OE, problemet financiare me të cilat janë përballur OE, me gjithë këto vështirësi, falë angazhimit të Kryetarit Elezaj dhe ekzekutivit është rritur realizimi i projekteve në lartësinë e cekur në raport. Edhe tek kategoria e shpenzimeve vazhdojmë të kemi një shpenzim racional të buxhetit, përkatësisht ulje të shpenzimeve në disa kategori. Rritjet si ne karburante është bërë për shkak të rritjes së çmimit të naftës për litër etj. Përfundimisht edhe në këtë kategori kemi zvogëlim të shpenzimeve. Marrë gjitha këto fakte ne si grup i AAK e konsiderojmë shumë pozitiv dhe inkurajojmë ekzekutivin që të vazhdojë me shpenzimin e tillë racional të buxhetit.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Po filloj me z. Kushtrim Haliti. Unë jam i vetëdijshëm që ata që janë për herë të parë në Kuvend e kanë më të zorshme që të i shkoqitin të dhënat, është raporti i parë që e akne në dorë. Çështjet që z. Haliti i ngriti edhe pse i ka në letër mbase ka nevojë që të i sqaroj. Fjala për shpenzimet që i përmendi, është fjala për punëtorët që e mirëmbajnë ambientin dhe kategoria e dytë janë 6 ekspertë të shpërndarë nëpër drejtori duke e ditur që numrin e punëtorëve nuk e caktojmë ne , nuk mund at rritim prandaj mungesën e ekspertëve na duhet ta plotësojmë me punëtor të tillë. Taksat për certifikata të ndryshme paguhen

në një vend. Në total arka e pagesat e ofiqarëve nuk ka ndonjë gabim por mund të jenë bartur ose tek certifikatat e lindjes ose tek ndonjë lloj tjetër. Për Zafer Gashin, me siguri do të sqaroj drejtori i shëndetësisë por kur thuhet se të gjitha parametrat dhe të gjitha shpenzimet janë më pozitiv se sa në vitin 2021, nuk deshta me i specifiku në detaje. Kjo nuk duhet të na bëjë të vetëkënaqemi por të bëjmë përpjekje të dalim akoma më mirë. Klina këtë vit është model për shpenzimin e mirë të buxhetit krahasim me komunat e tjera por angazhimi i kryetarit bashkë me ekzekutivin , angazhimi i tyre ka bërë që kjo të jetë e mundur.

z. Kushtrim Haliti: Rritja e buxhetit nuk jam i sigurt kush e tha , që tha se kemi rritje prej 9%, saktë po i bien ashtu siç thash unë, ato 1 milion e 132 mijë euro janë bartur.

z. Valmir Bacaj: Realizim 100% akoma nuk kam dëgjuar që ka ndonjë komunë që e ka realizuar ndërsa po është e vërtetë që është rrit 9% buxheti krahasuar me vitin 2021.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne kemi pasur një përkujdesje të veçantë që grandin qeveritar të shpenzohet 100% por normal ne nuk kemi pasur mundësi që ta shpenzojmë 100%, është shpenzuar në 79%. Kemi pasur kujdes shumë të madh që të hyrat vetanake të na mbesin që ne të kemi mundësi ti bartim për vitin e ardhshëm. Për këtë të arritur të shpenzimit të buxhetit në 79% sigurisht që do të shpërblehemi përsëri me grandin qeveritar.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Përhëndetje të gjithëve. Dy sqarime kam për çështjet që u ngritën këtu. E para ka të bëjë me një komunikatë që dega e PDK në Klinë e ka postuar në lidhje me një çështje që u përmend këtu nga zonja kuvendare për mungesë të furnizimeve me barnat në QKMF në Klinë. Komuna e Klinës ka dy kontrata për furnizim që janë të nënshkruara në vitin 2020 dhe 2021. Pra kanë validitet kohor këtë vit dhe për vitin e ardhshëm. Nga këto dy kontrata QKMF furnizohet me barna por përveç këtyre furnizohet edhe nga Ministria e Shëndetësisë që është lista e barnave esenciale. Sipas asaj që ju e dini ka mungesa nga kjo listë e barnave esenciale, pra, nuk furnizohen mjaftueshëm jo vetëm QKMF në Klinë por të gjitha QKMF-të e tjera. Furnizimi nga ministria e kësaj liste nganjëherë bëhet më mirë e nganjëherë më pak. Zakonisht mungesa nga kjo listë ka nga fundi i vitit në muajin dhjetor. Ne kemi marrë zotim nga ministri “i ri” që do të kemi furnizim më të mirë. Por sa i përket kontratave që kemi mund të themi se furnizimi ka qenë më i miri, QKMF asnjëherë nuk ka mbetur pa barna në barnatoren e vet. Unë e kam lexuar komunikatën e PDK-së dhe ka qenë për keqardhje . Nuk guxon një parti serioze që ka qeverisur dy tre mandate këtu të deklaroj se ka keqpërdorim të parasë publike pa fakte. Ajo foto që ka dalë aty është nga marrja e një donacioni të vogël. Donacioni ka qenë i vogël prandaj edhe vet donatori se ka pa të arsyeshme që ta bëjë publike. Në vitin 2022 ne si QKMF kemi bërë shpenzime në vlerë prej 3200 euro. Krejt këto furnizime me barna. Furnizim me laborator për regjenca jemi furnizuar përafërsisht 15 mijë euro dhe një furnizim për filma të rëntgenit ka qenë 10.870,00 euro. Përveç këtyre kemi pasur edhe një furnizim tjetër me pajisje që është e veçantë në vlerë 59 mijë euro përafërsisht e keni në raport, bëhet fjalë për një furnizim me pajisje mjekësore që ka shkuar përmes prokurimit publik. Ne kemi rekrutuar mjekë të rinj dhe ata kanë pasur nevojë për pajisje mjekësore, javën e ardhshme do ta bëjmë shpërndarjen e tyre. Edhe një sqarim tjetër, rëntgeni ju ka ofruar shërbime qytetarëve në 7000 raste. 7000 qytetarë kanë marr shërbimet e rëntgenit, ne kemi shpenzuar 10. 870 euro por qytetarëve jua kemi kursyer afër 80 mijë euro. Po ashtu tek shërbimet e qytetarëve për analiza ku qytetarëve jua

kemi kursyer rreth 50 mijë euro. Pra, shpenzimet tona janë rreth 32000 euro por qytetarëve jua kemi kursyer rreth 600 mijë euro.

z. Esat Raci: PDK ka qenë është dhe do të mbetet Parti shumë serioze. Ka udhëheq në mënyrën më të mirë të mundshme ku projektet e pushtetit të PDK preken dhe do të preken nga qytetarët e Komunës së Klinës. Asamblistja pyeti për periudhën një mujore se pse QKMF nuk ka kontratë. Nga i kemi marrë ne ato informacione ti pasi që po e din drejtor është dashtë ta thuash emrin por nuk qëndron ajo që the. Ne burim e kemi qytetarin e Komunës së Klinës. Katër qytetarë më kanë thirrë dhe tregu që nuk kanë pasur trajtim me barna esenciale.

z. Zafer Gashi: Unë thash që duhet me pas kujdes se mund të ju qesin në lajthitje shitësit. Po ndalna pak edhe pse nuk kam dashur të merrem me atë që ka dalë nga PDK edhe pse është e vërtetë ajo që është shkruar në atë komunikatë. Donacioni epet një ditë e nuk epet për çdo ditë. Merr një paketë një ditë merr një ditën tjetër, Këtë punën e donacionit mos ma trego mua.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Nuk thash që PDK nuk është Parti serioze , është serioze thash dhe ka qeverisë disa mandate duhet të i dijë këto punë. Kemi dy kontrata për furnizim me barna, nuk kemi të drejtë me dalë me ble barna në barnatore private, nuk guxojmë ta shkelim ligjin. Mangësi ka pasur tek lista e barnave esenciale, ato artikuj nuk kemi të drejt të blejmë me kontrata. Zaf, ai furnizim që është bërë atë ditë në barnatoren e Vilsonit është bërë donacion. Në proces verbal është e evidentuar si donacion, ne e vlerësojmë kur me shkuar me e marrë atë donacion, vlera ka qenë e vogël dhe nuk është bërë publike. Përndryshe gjykatat janë për të gjithë për ne për ju dhe për të gjithë. Fjala publike ka përgjegjësi kur të thuhet, nuk duhet me ardhë në nivel me i shantazhu njerëzit me foto, me video kush po hyn në një barnatore të filanit. Ata që i kanë bërë këto nuk janë më këtu hiç, kanë ik në 1999 prej këtu.

z. Esat Raci: Këtu jemi përfaqësues të popullit të Klinës nuk jemi në parti politike. Nuk thamë që ka pasur shkelje të ligjit. Jemi të thirrur që shqetësimet e qytetarëve me u ngrit. Ju si ekzekutiv të mbroheni qysh po mbroheni.

z. Zafer Gashi: U përdor fjala shantazh. Nuk ka pasur asnjë lloj shantazhi ndaj askujt. Ajo foto është bërë që të ju tregohet se asi furnizimi është bërë disa ditë me radhë dhe jo një ditë të vetme. Shantazh është kur dikujt nuk ka dashtë kryetari me ja marr familjarin në punë dhe ai e ka shantazhuar me një video e jo kjo që është publikuar për me tregu qysh e thash më herët e jo për favore.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Unë e kam përcjell me vëmendje raportin financiar dhe pajtohet krejtësisht me atë që e tha Valmir Bacaj. U fol shumë për shëndetësi, dua ta falënderoj shumë drejtorin jo sepse jemi të së njëjtës parti por sepse unë vet kam marr shërbimet aty, në rëntgen dhe kam marr shërbimet më të mira. Asnjë qeveri nuk është interesuar për qytetarin për sigurime shëndetësore dhe nuk është mirë të ankohe mi shumë për barna esenciale.

z. Arben Limanaj: në pyetjen time për punëtorët që nuk janë në listë të pagave por me kontratë. Drejtori e përmendi që ka kontrata në vepër, Nëse ka kontratë në vepër është e paligjshme, Kontratat në vepër janë të ndaluara. Nëse ka gjithmonë.

z. Kushtrim Halitaj: Unë dëshiroj të i them Agron Bacaj se nëse na krahasoi neve të PDK-së me ata të 1999 duhet ta diji ai se PDK është njëra nga partitë kryesore bashkë me Aleancën që i ka largu ata.

Reagon drejtori z. Bacaj duke thënë se e ka pas fjalën për ata që bëjnë foto dhe video dhe shantazhojnë qytetarët. Reagon edhe kryesuesi Gashi duke thënë se nuk e ka thënë ashtu z. Bacaj se do të ndërhynte edhe ai gjithsesi.

Znj. Arta Pantina: Dëshiroj të kërkoj nga drejtori i shëndetësisë që të na sjell një listë të barnave që blihen dhe ato që merren nga ministria e shëndetësisë. Unë si qytetare e Klinës shpeshherë kam marr shërbimet në QKMF dhe kam parë që ka mungesa të barnave. Gjithashtu për rëntgen nuk e diji kur është furnizuar me rëntgen sepse në vitin 2022 kam pasur nevojë për rëntgen dhe nuk ka pasur jam detyruar me shkuar me be skanimin në laborator privat. Drejtori i financave bëri krahasimin mes viteve 2021 dhe 2022, këtu është raport financiar i vitit 2022 nuk duam të bëjmë krahasime por të japim mesazhin e shpenzimeve sa më racionale.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: znj. Pantina të dy kontratat për furnizime me barna janë të vlefshme dhe të dy listat e kontratave me artikuj janë publike, mund të i gjeni në ueb faqen e Komunës ndërsa lista e barnave esenciale është në ueb faqen e ministrisë, është unike për të gjithë shërbimin parësor shëndetësor.

Pika e 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së ekzekutivit për vitin 2023.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Plani i ekzekutivit është i bazuar në dokumentet politike të nxjerra nga Kuvendi i komunës dhe draft strategjia që do të aprovohet së shpejti që ka parametra të rëndësishme që janë marr për bazë gjatë hartimit të këtij plani. Gjatë punës dhe ushtrimit të funksioneve të ekzekutivit përkatësisht qeverisja komunale, aktivitetet për realizimin e synimeve kryesore do ti ndërlihdë edhe me dokumentet strategjike të nivelit qendror që janë plani kombëtar për zhvillimin e Kosovës, plani afatmesëm i shpenzimeve buxhetore sigurisht edhe dokumente të tjera të rëndësishme që akne të bëjnë edhe me integrimet Evropiane.

Hapet debat

z. Zafer Gashi: Besoj që po diskutojnë për diçka më të mirë. Kur jemi te ky plan do të kërkoja të jemi real. Situata ka ndryshuar krahasim më vitin 2022. Tani ne kemi pasur dy goditje natyrore shumë të mëdha sidomos kjo e dyta prandaj ne si grup kuvendar por ftoj edhe PDK dhe LDK që kësaj radhe mos të votohet ky plan i punës në mënyrë që të i japim mundësi qeverisë komunale që të reflektojnë në vërejtjet tona. Po nisi me drejtorinë e administratës, e kam parë edhe në prokurim që 55 mijë euro janë ndarë për renovim të kuvendit , do të doja që këto mjete të shkojnë në drejtorinë e bujqësisë dhe shërbimeve publike sepse dihet çfarë pune i pret në të ardhmen duke ditur sa dëme janë bërë në rrugë etj. Te kjo drejtori, mund të shkruash por nëse nuk realizohet ne do të jua përmendim, për të drejtat e njeriut me pas parasysh barazinë gjinore. Tek shëndetësia, e shohë që dy herë, përmirësimi i shëndetit reprodaktiv për gratë dhe vajzat e reja. A keni ju kuadro dhe me çfarë metodash keni me e përmirësua? A keni me mbajt ligjërata të rinjve se si duhet të bëjnë fëmijë më shumë apo si se nuk e kuptoj? Sigurimi i një aparati për

mamografi, nëse këtë e bëni ne do të ju përkrahim. Një program që më ka pëlqyer është planifikimi i vizitave për fëmijët prej 0 deri në 3 vjeç Por mendoj që nuk keni staf. Në fshatin Kpuz fare nuk ka ambulancë shëndetësore, ju lutem që ta fusni në buxhet dhe të bëhet ky fshat më një ambulancë shëndetësore. Respekt për punën tuaj drejtor gjithsesi. Drejtoria e Arsimit, 11 vende e keni përmendur – fillimi i inicimit të procedurave të prokurimit. Ma shpjegoni pak këtë se nuk e kuptoi. Drejtoria e financave veç e tregoj planin e tij por ka këtu diçka- a do të përdorni masa ndëshkuese ndaj njerëzve që nuk paguajnë detyrimet. Drejtoria për kulturë shumë planifikime të mira, por keni harruar një klub që është shumë i suksesshëm, klubin e boksit. E përgëzoj drejtorin e kadastrës që e ka shkruar një fjalë shumë të qëlluar që është “ përsëri përballemi me probleme”, më të vërtetë kjo drejtori ka shumë punë sidomos duhet pasur kujdes me pronat që epen me qira. Tek Urbanizimi- ndërtimi i stacionit të autobusëve, 34 mijë i keni në prokurim, sa është shuma ? A është tejkualuar shuma e projektit? çka ka me u punuar aty më derisa i keni vendos autobusët. Një tjetër gjë që po gabohet shumë-Mos të përdoret togfjalëshi Ujë i pijshëm në Klinë. Ne kemi të drejt ta padisim “Hidrodrinin” dhe organet e tjera sepse në Klinë nuk ka ujë të pijshëm. E vetmja komuna që paguan për ujë të pijshëm dhe nuk furnizohet me ujë të pijshëm jemi ne. Liqen grumbullues është investim në ujë që mund të ndotet, pse të investohet në këtë. Që 4 vjet fabrika nuk punon që do të duhej atë ujë të liqenit grumbullues ta filtronte. Fundërrues po ashtu nyejt, 100% nuk e pastron fundërruesi ujin. Rasti i Pusit të jaranes, nuk ja vlen ai projekt sepse kosto e pompimit është i shtrenjtë nuk mund ta mbulojmë. Ne duhet të investojmë në blerjen e filtrave dhe ta aktivizojmë fabrikën e ujit. Drejtoria e shërbimeve publike për herë të parë po më pëlqen kjo – jo me planifikuar por me e realizuar trajtimin e qenve endacak, me e ble një ekskavator për shërbimet publike është shumë e qëlluar.

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë me shumë miqësi po jua kërkoj të gjithëve sidomos juve Zafer. Të gjithë këtu kemi identitetin tonë politik edhe personal, nuk kemi nevojë me bërë thirrje tek identitetet e tjera politike se si të votojnë. Ky Kuvend jo në këtë mandat ka miratuar planin e veprimit për ruajtjen e integritetit sikurse atë etik, veshjes etj., kërkoj që secili prej nesh të jemi më zyrtar , më shumë korrekt edhe me veten edhe me kolegët sepse shëndeti coftë i neve coftë i të rinjve e të rejave nuk është lojë as për me qeshe as me i injoruar as me i qit nëpër gaborre të ndryshme sepse ato të rinj e të reja janë të familjeve tona dhe nëse ka ndonjë gatishmëri për me ju qëndruar afër coftë prej trajnimeve apo investimeve të ndryshme, mendoj që lipset vëmendja e secilit prej neve dhe investimi ynë duke bashkëpunuar edhe me drejtorinë edhe me akter të tjerë cofshin vendor apo ndërkombëtar. Më e rëndësishmja është se këtë dokument që ju e keni përpara të punuar nga ekzekutivi është më mirë nga ne pozitë e opozitë që ta përcjellim se a po implementohet qysh është planifikuar se sa të debatujmë sot se a do të implementohet a jo nesër. Kur e lypa seriozitetin nga secili nga ju e kisha fjalën kur deklaruar z. Gashi, të hiqen 55 mijë euro nga renovimi i sallës së Kuvendit dhe të barten në një drejtori tjetër. Nuk mendoj që duhet të behët ashtu sepse ju po e shihni në çfarë kushtesh je duke folur. Investimi në këtë sallë i përket mirëqenies tuaj. Edhe një herë duke e përfunduar, miqësisht me duhet të jua përkujtoj se zyrtarisht për një çështje ju keni të drejt te flisni 3 minuta.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Propozimi që dha Zaferi, mendoj që kemi kompetenca dhe mundësi që ta tejkalojmë këtë vështirësi të vërshimeve sepse ne kemi mbi 1 milion euro që do të barten nga buxheti i kaluar e që unë kërkoj bashkëpunim të plotë nga secili nga ju që paraprakisht të na

bëni kërkesë se cilin projekt dëshironi të zhvilloni. Asnjë pengesë nuk është që sot të miratohet plani i punës dhe në vijimësi të merremi me zgjidhjen e çdo shqetësimi të shprehur. Kur është fjala për furnizim me ujë të pijshëm, unë falënderoj kryeministrin Kurti që ka themeluar një komision për këtë çështje dhe planifikimet tona janë bërë plotësisht në përputhje të plotë me vlerësimin që ka bërë komisioni.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Në lidhje me projektin e vizitave të fëmijëve prej 0 deri 3 vjeç dhe gratë shtatzëna, që e përmendi Zaferi, ky projekt ka dy vite që është implementuar tani është viti i tretë. Është mbështetë nga Ministria e Shëndetësisë dhe UNICEF. Për mbarëvajtjen e këtij programi, QKMF ka fituar një veturë të re për këtë qëllim. Në raport të punës që do të ju vije në seancën e shkurtit janë të specifikuar të gjitha shërbimet që kryhen në QKMF. Shërbimet që kruhen në QKMF janë të parapara në udhëzimin administrativ të ministrisë së shëndetësisë.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Dëshiroj të sqaroj z. Zafer Gashi në lidhje me masat ndaj atyre që nuk e kryejnë me kohë pagesën e tatimit në pronë. Ne do të bëjmë njoftimin me kohë të gjithëve sikurse çdo vit në të kaluarën dhe natyrisht është edhe përmbaruesi që në fund do të angazhohet.

Në vazhdim u diskutua për vendimin e fundit të qeverisë për rritjen e vlerës së pronës dhe rritjen e tatimit në pronë ku morën pjesë drejtori i FEZH, z. Enver Berisha, z. Zafer Gashi, Kryesuesi, z. Fadil Gashi, kryetari i komunës, z. Zenun Elezaj, z. Tunë Dedaj, z. Valmir Bacaj, etj.

Plani i punës për vitin 2023 u vendos në votim dhe me 23 vota për, dy abstenim , asnjë kundër U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për vënie në diskutim publik të draft planit komunal për menaxhim të mbeturinave.

Kryesuesi theksoi se është vetëm vendim për vemjen në diskutim publik dhe që do të vijë prap në kuvend për debat.

Fjalën e morri z. Kolë Prenaj i cili theksoi se ky është një plan shumë i rëndësishëm dhe dëshiroj që të merr pak kohë për ta shtjelluar. Kryesuesi ndërhyri duke theksuar se është një vendim për vënie në diskutim publik ku do të diskutohet nga publiku e që prap do të kemi mundësi për debat mbi këtë plan. Z. Prenaj nuk ishte dakord me hartuesin e këtij plani pasi që nuk janë prekur disa çështje shumë të rëndësishme sa i përket menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe ato sanitare. Z. Prenaj kërkoj mundësinë e themelimit të një komisioni për përgatitjen e një projekti për ekoturizmin dhe ai projekt të ju ofrohet donatorëve. Foli për partneritetin publiko privat për përpunimin e shume lloje te mbeturinave duke e mbyllur me apelin që të gjithë bashkë të kontribuojnë pozitivisht në këtë draft plan.

Diskutimit rreth këtij plani ju bashkua edhe z. Esat Raci duke thirrur të gjitha ata që akne mundësi të kontribuojnë në përpilimin sa më të mirë të këtij plani deri në aprovim. Edhe kryesuesi theksoi se kontributin të gjithë ne duhet ta jepim në këtë draft plan deri në aprovim dhe pasi të aprovohet të shihet implementimi.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.

Pika 8 e Rendit ët Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për vënie në diskutim publik të draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.

z. Zafer Gashi në këtë pikë theksoi se krejt kjo po shihet sikurse është e pavarur njësia “Ambienti”. Sa kam informacion është iniciuar nga kryetari që ne të pavarësohemi nga Peja dhe mendoj që është e qëlluar. Por duhet pasur parasysh që do të kemi vështirësi, Ne nuk kemi vend për deponi. Kamionët që mbledhin mbeturinat harxhojnë karburante, janë disa gjera që duhet të merren parasysh. Sa i përket mbeturinave medicinale, sa e diji ka pasur një lloj furre që janë djegur këto mbeturina, tash për tash unë personalisht kam bashkëpunim me entin higjenik në Pejë ku i dërgoj këto mbeturina dhe paguaj për to. Mbeturina medicinale të hedhura gjithandej ka edhe sot , sidomos aty afër poliklinikës sime. Nëse realizohet ky pavarësim efikasiteti në menaxhim do të jetë më i madh gjithsesi.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Nuk guxon që të shkatërrohen mbetjet e rrezikshme si ampula, shiringa etj. Po shqetësohem se si ordinancat private i hedhin në kontejnerë, mendoj që inspektorati duhet të merret me këtë. Si QKMF ne nuk i shkatërrojmë ato mbetje, kemi marrëveshje me spitalin e Pejës ku i dërgojmë një pjesë të këtyre mbetjeve medicinale por barna etj. janë procedura të tjera ligjore se si duhet të trajtohen.

z. Valmir Bacaj: Ne sot po marrim një vendim për vemjen në diskutim publik të kësaj draft rregullore. Ne do ta japim kontributin tonë edhe kur të vijë kjo draft rregullore në Kuvend. Si Komision i aksionarëve të votuar nga kjo asamble ne jemi të informuar për gjendjen në të cilën ndodhet kompania “Ambienti”. Aktualisht kompania funksionon si KRM. Tri komuna tani kanë angazhuar një kompani konsulentë për shpërbërjen e kompanisë rajonale të mbeturinave me qëllim që të shndërrohen në NPL- ndërmarrje publike lokale, për këtë kemi nënshkruar edhe memorandumet edhe si komision i aksionarëve edhe ju si kryesues edhe kryetari i Komunës. Procedura është në Qeverinë e R. së Kosovës dhe presim përgjigjen.

Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Prokurimit për vitin 2023

z. Zafer Gashi theksoi se planifikimet janë shumë të mëdha dhe se ka pasur mundësi që të racionalizohen këto. Ndërsa kryesuesi theksoi se këto nuk janë shuma që do të paguheshin por janë vetëm të planifikuara dhe orientimi i shpenzimeve. Z. Tunë Dedaj theksoi se është mirë që të shikohen ofertat jo serioze kur të zhvillohen procedura prokurimi.

Me 23 vota për , 2 abstenime , asnjë kundër MIRATIHET

Pika 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSB për vitin 2023.

Znj. Marqe Tanushi- Selmanaj, nënkryetare e Komunës: Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë, asamblistë dhe asambliste, qytetarë dhe Qytetare të Klinës. Po e theksoi aspektin gjinor, do të ishte shumë mirë që të potencohet. Sadopak do të ishte mirë që të respektohet sepse para neve janë 11 zonja e zonjusha që janë po aq të vlefshme sa ju të gjithë të tjerët. Si zëvendës

kryesues i këtij këshilli po e shpalosi planin e punës. Ky plan synon që të identifikoj aktivitetet, qëllimet, rezultatet përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ për KKSB. Roli i KKSB në komunën tonë ka rendësi të veçantë sepse identifikon dhe mbledh shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, kulturore etj. dhe ato shqyrtohen bashkë me institucionet e Komunës dhe organet e sigurisë dhe tentohen të zgjidhen në dobi të qytetarëve. Bazuar në udhëzimin administrativ duhet që KKSB të mbaj 6 takime dhe edhe të shtohen takimet bazuar në kërkesat e anëtarëve të KKSB-së. Në këto takime shqyrtohen mundësitë e përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Në vazhdim të shpalosjes së planit të punës, znj. Selmanaj listoj aktivitetet konkrete që planifikohen të zhvillohen për vitin 2023 nga KKSB.

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 11 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi i vendimeve sipas kërkesave të Ministrisë së planifikimit hapësinor dhe Ministrisë së Pushtetit lokal.

Kryesuesi lexoi vendimet që janë kërkuar që të rishqyrtohen, vendimi për shpallje zona me interes publik brigjet e lumit “Drini i Bardh” dhe theksoi se jemi të obliguar që ta tërheqim këtë vendim.

z. Tunë Dedaj: Shumë interesant se në Ministri marrin vendime kur nuk e dinë as ku janë rrugët tona as hapësirat, thjesht thonë se nuk bënë që të shpronësohet.

Me 24 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA tërheqja e vendimit për shpalljen zonë me interes publik të brigjeve të lumit “ Drini i Bardhë”

Vendimi tjetër është për ri formatizimin e KPF-së dhe kërkesa e ministrisë është për rishqyrtim.

Kryesuesi theksoi se vendimi nga kuvendi është marrë bazuar në udhëzimin administrativ që e rregullon këtë çështje. Përshtypje i është bërë dhe shpreh pakënaqësinë e tij gjithashtu për shkresat që vonohen për konfirmim të ligjshmërisë nga ministria e linjës ndërsa efikasiteti në këtë rast ka qenë rekord. “ Unë i ka pranuar tri shkresa për këtë vendim. Një e kam pranuar nga zyra ligjore, një nga LVV dhe e fundit nga ministria e linjës” theksoi kryesuesi Gashi duke vazhduar :” Shkresa e LVV që ju ka referuar rastit nuk ka të bëjë me realitetin”.

Kryesuesi lexon shkresën e deponuar nga LVV : Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e mbajtur me datë 20. 12. 2022 jashtë rendit të ditës(kryesuesi thekson se nuk ishte jashtë rendit të ditës. Kishte hyrë në rend dite me kërkesë të grupit të PDK-së dhe mbështetur nga grupi i AAK)merr vendim që subjektit politik LVV i merret përfaqësimi në KPF, ku kanë qenë të përfaqësuar me një anëtar bazuar në 0.78% të % së fituara në Kuvend. Pasi që një këshilltare e këtij subjekti politik ka kaluar e pavarur, këtë vendim e marrin anëtarët e kuvendit në krye me grupin kuvendar të AAK-së si grupi më i madh kuvendar me idenë se LVV nuk i takon asnjë vend – përfaqësim në KPF pasi që në mungesë të anëtarit të tretë nuk përbën grup kuvendar. Komenton kryesuesi: këtu nuk qëndron e vërteta. Anëtari i PDK-së që ka kaluar në grupin tjetër është zëvendësuar e jo i LVV. Udhëzimi e thotë kështu: kur anëtari i një grupi kuvendar përfaqësues në KPF kalon në një subjekt tjetër e humb përfaqësimin e subjektit të mëparshëm

prandaj duhet zëvendësuar nga subjekti paraprak. Tek LVV nuk e kemi rastin e njëjtë. Situata që ju keni referuar nuk ka të bëjë me grup. Udhëzimi administrativ e thotë që të fillohet me grupin më të madh kuvendar ndarja e vendeve në KPF që unë në këtë rast AAK i takonin 3 anëtarë dhe vazhdon me grupin e dytë më të madh kuvendar, të tretin e kështu me radhë derisa të plotësohet numri i caktuar i përfaqësuesve në KPF. Në rastin tona, fillon me grupin Kuvendar që i takonin 3 anëtarë sipas % së fituar, PDK-së me 2 anëtarë, LDK-së me 2 anëtarë dhe LVV me 1 anëtarë. Por më tregoni si të i ndajmë këta 8 anëtarë kur KPF tek ne është në përbërje vetëm me 7 anëtarë.

z. Esat Raci, shef i grupit kuvendar të PDK-së thekson se e ka kuptuar përgjigjen e ministrisë dhe kërkon reflektim nga partia më e madhe- AAK që mos të mbesim peng i kësaj situatë të krijuar . Z. Raci theksoi gjithashtu se vazhdimisht ka kërkuar që të bëhet zëvendësimi i anëtarit të PDK-së që ka kaluar në grupin tjetër politik dhe kjo është e drejtë e tyre.

Edhe kryesuesi theksoi se kërkohet mirëkuptim nga grupi i AAK-së që mos të vazhdohet më tej me këtë procedurë pasi që mund të përfundojmë në gjykata dhe mund të ndikojnë në performancën e Komunës. Z. Gashi theksoi se nuk është gabimi i kuvendit nëse i referohemi udhëzimit administrativ. Ai tha se këtë çështje e ka në dorë AAK dhe kërkoj që për hir të bashkëpunimit të reflektoj e jo sepse nuk ka të drejt AAK që ti ketë 3 anëtarë.

z. Valmir Bacaj shef i grupit kuvendar të AAK-së , theksoi se shpejtësia e kthimit të përgjigjes nga ministria është për tu çuditur sepse nuk ka ndodhë në të kaluarën që të marrim përgjigjen kaq shpejt. Ne, thotë ai, në seancën e kaluar ju kemi referuar % së fituar në Kuvend ashtu siç i referohet edhe ministria sipas ligjit. Z. Bacaj theksoi se ministria ka specifikuar në përgjigje se LVV i takon një anëtar në KPF por nuk e ka specifikuar se sa anëtarë i takojnë AAK, PDK dhe LDK. Nëse do të specifikohesh edhe për grupet tjera do ta shihnin se LVV nuk i takon asnjë përfaqësim në KPF prej 7 anëtarëve. Propozimi ynë është që të kërkohet një sqarim nga Ministria e pushtetit lokal që të specifikojnë se sa anëtarë i takojnë AAK, PDK LDK dhe LVV në KPF e Klinës. Përgjigja e tyre mund të shqyrtohet në një seancë të jashtëzakonshme. Nuk po kërkojmë as me marrë më shumë as më pak por vetëm aq sa na takojnë.

z. Arben Limanaj , shef i grupit Kuvendar të LDK-së theksoi se ne si kuvend po bimë në lajthitje. Nëse edhe AAK ti ketë 3 anëtarë dhe LVV ta ketë 1 anëtar si do të veprojmë ne në këtë rast. Mirëkuptimi nuk u realizuar në seancën e kaluar, shkresa e ministrisë kërkon rishikim.

z. Zafer Gashi nga LVV theksoi se ju e keni lexuar shkresën e Ministrisë së Pushtetit Lokal, të cilën shkresë në pika të shkurtra e lexoi, dhe vuri theksin se KPF përbehet në bazë të numrit të ulëseve të fituara në zgjedhjet e fundit Komunale. Sipas z. Gashi gjithçka është shumë e qartë dhe LVV i takon një anëtar në KPF prandaj z. Gashi pret mirëkuptim për këtë të drejtë edhe nga AAK edhe nga PDK e LDK.

Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj tha se i intereson që të gjendet një konsensus duke kërkuar bashkëpunim mes grupeve kuvendare. Z. Elezaj propozoj që shefat e grupeve bashkë me kryesuesin dhe kryetarin e Komunë të ulen 5 minuta bashkë dhe të gjendet një konsensus. Nëse nuk bëhet një zgjidhje mund të penalizohemi në grandin e performancës.

Të gjithë u pajtuan që të merret një pauzë 15 minutash që të provohet gjetja e një konsensusi.

Pas pushimit prej 15 minutave dhe konsultimit të shefave të grupeve kuvendare bashkë me kryesuesin, z. Fadil Gashi dhe Kryetarin e komunës, z. Zenun Elezaj, grupi kuvendar i AAK-së u pajtua që të veprohet sipas çelësit 2-2-2-1 anëtarë të KPF-së. Në emër të grupit kuvendar, shefi i grupit, z. Valmir Bacaj bëri deklarin:

z. Valmir Bacaj: Ne patëm një takim si grup kuvendar i AAK-së dhe vendosë që të i përgjigjem shkresës sikurse ka kërkuar Ministria e PL por me një kusht që në ndërkohë të i bëhet një kërkesë ministrisë në fjalë që të e specifikoj se sa anëtarë i takojnë grupit kuvendar të AAK-së dhe grupeve të tjera. Këtë lëshim po e bëjmë për hir të qytetarëve të Komunë së Klinës që mos të humbin në grandin e performancës.

Kryesuesi theksoi se politikisht është kështu siç tha Valmiri ndërsa juridikisht AAK-së i takojnë 3 anëtarë gjithsesi. Vazhdoj duke theksuar se duhet të specifikohet saktë se kush e liron vendin nga AAK dhe kush futet nga LVV.

Grupi kuvendar i AAK-së liron vendin në KPF duke hequr z. Bledar Berisha nga anëtari i KPF dhe propozohet znj. Valmire Krasniqi nga LVV , anëtare e KPF-së.

Me 22 vota për, 1 abstenim dhe asnjë kundër u MIRATUA.

Pika 12 e Rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje.

Para se të filloj kjo pikë e rendit të ditës, kryesuesi z. Fadil Gashi kërkoj edhe nga Ekzekutivi që të gjitha komitetet dhe komisionet e formuara të kompensohen.

z. Kushtrim Haliti, thekoi se as komisioni të cilin ai e kryeson edhe pse ka punuar dhe vazhdon të punoj në teren akoma nuk është bërë asnjë lloj kompensimi sipas vendimit të Kuvendit. Ai thekoi po ashtu se prej që është thënë që nuk do të kompensohet komisioni në fjalë, anëtarët e këtij komisioni nuk po dalin në teren.

Znj. Lirie Gashi: Edhe unë dua të ndërlidhem me shqetësimin e Kushtrimit sepse edhe unë jam anëtare e komisionit dhe do të doja të kem një përgjigje: cili nga ju do të kishte mundësi të del në teren dhe të punoj dhe të mos kompensohet?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Do të ishte mirë që të bëhet një takim mes mua si kryetar, juve të komisionit dhe drejtorit të financave. Nëse duhet të merret një vendim shtesë , ta marrim atë dhe bëhet kompensimi i duhur.

Znj. Valmire Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë. Pasi që ju vazhdimisht keni theksuar mungesën e Ministrin të shëndetësisë, tani ne e kemi Ministrin por ju ku e keni drejtorin e QKMF-së dhe edhe sa kohë duhet të vazhdoj ushtrues detyre i QKMF-së personi që tani ushtron atë detyrë?

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Në bazë të ligjit për zyrtar publik ushtrues detyre mund të qëndrojë maksimumin 6 muaj. Ushtruesi i detyrës aktualisht akoma nuk i ka arritur 6 muaj të ushtrimit ët detyrës në fjalë. Akoma nuk kemi shpallur vendin e punës në Konkurs shkaku i

statutit të QKMF-së. Ne tani statutin e kemi gati dhe në seancat e ardhshme do të sjellim draftin në Kuvend, Do të i ndjekim hapat ligjor me shpallje të konkursit dhe të tjera.

z. Zafer Gashi: Kam një pyetje për drejtorin e administratës. Ka qenë në media prania e një punëtori të komunës në protestat e organizuara në veri të Mitrovicës. A keni informacion se a ka qenë në orar pune punëtori në fjalë kur ka marr pjesë në atë protestë?

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Po , kemi folur me punëtorin në fjalë por ai i përgjigjet direkt zyrës për komunitete dhe kthim. Ai ka marrë një vërejtje dhe nëse përsëritet do të shkoj në komision disiplinor.

z. Enver Gashi: kam edhe unë një pyetje për drejtorin e Administratës. Kemi Shqetësim nga shumë zyra të gjendjes civile nëpër BL , kemi shumë raste kur për një fotokopje të dokumentit duhet të shkohet në Klinikë.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Po e vërtetë. Kemi dijeni për këtë shqetësim por neve nuk na lejohet të ndërhyjmë më shumë se sa të bëjmë vërejtje sepse kontrata është e nivelit qendror për furnizim dhe riparim të fotokopjeve.

z. Lirie Gashi: Unë sot kam një kërkesë për drejtorin e Arsimit. Si anëtare e komitetit për arsim, rini dhe kulturë kërkojmë që nëpër shkolla të ketë psikolog sepse është shumë e domosdoshme. Kam edhe një pyetje për drejtorin e shëndetësisë: QKMF a ka pediatër sepse shumë herë kemi pasur nevojë për pediatër dhe nuk e kemi gjetur aty.

z. Qemajl Sejdiya, drejtor i arsimit: Të nderuar të pranishëm. Mungesa e psikologëve është shqetësim dhe këtë shqetësim vazhdimisht jua kemi drejtuar ministrisë së arsimit. Një herë e kanë planifikuar që me grand të shtohet numri i psikologëve.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: QKMF ka pediatër aktualisht edhe pse pediatri ka probleme shëndetësore shkak i moshës. Po i kryen shërbimet me mundësitë që ka. Ne jemi duke shikuar që të rekrutojmë një pediatër nëse na lejohet nga ministria. Përndryshe vendimi është që mjeket – specialist të mjekësisë familjare të ofrojnë shërbimet për fëmijë.

z. Tunë Dedaj: Dua të shpreh një shqetësim të prindërve të nxënësve të shkollës fillore “ Ismet Raci”. Aty çdo klasë prej të parës deri në të pestën i ka mbi 40 nxënës. Kërkoj nga ju që të mos ketë më shumë se 25 nxënës në Klasë.

z. Qemajl Sejdiya, drejtor i arsimit: E kemi pranuar këtë shqetësim dhe regjistrimi që ka ardhur tani për klasat e para është se numri i nxënësve në klasë është 27 nxënës. Tek klasat e tjera nuk kemi pasur mundësi të intervenojmë dhe na është dashur që ta lejmë ashtu siç është numrin e nxënësve në klasë. Me udhëzim administrativ është që numri i nxënësve në klasë të jetë 31. Ne do ta reduktojmë këtë numër gjithsesi.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut duke e falënderuar grupin kuvendar të AAK-së për kompromisin e arritur dhe shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesi:

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-5625 /23

Klinë: 21.02.2023

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 13.02.2023

Komiteti për Politikë dhe Financa, në seancën –II-të të rregullt për vitin 2023, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në Kuvend këto pika:

Pika 1. Shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022.

-Lidhur me këtë pik të rendit të ditës, drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Enver Berisha, theksoi se, sa i përket këtij raporti mund të flasim gjerë dhe gjatë sepse pasqyron punën e ekzekutivit të cilën ne e kemi kryer gjatë vitit 2022, rreth këtij raporti më gjerësisht mund të diskutojmë në kuvend, andaj kërkoj që raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2022 duhet të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022, rekomandoi që të bëhet një rishikim sa i përket radhitjes dhe lekturimit të tij deri në seancë, po ashtu rekomandoi që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i propozimit të Drejtorisë për FEZH për bartje të mjeteve.

Drejtori i Drejtorisë së FEZH, theksoi se të hyrat vetanake të vitit 2022 të cilat do të barten në vitin 2023 janë në shumën prej 1,322,987.61 €. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, Ligjit për buxhet për vitin 2023 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo, propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nënprogramet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 60,000.00 €;
- Shpenzimet komunale në vlerë prej 35,000.00 €;
- Shpenzime kapitale në vlerë prej 1.207.987.61 €;
- Subvencione dhe transfere në vlerë prej 20,000.00 €.

Në kategorinë mallra dhe shërbime - Infrastruktura Rrugore (18018), vlera prej 60,000.00 €;
Në kategorinë e shpenzimeve komunale - Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), vlera prej 25,000.00 €;
Administrata e arsimit (92090) vlera prej 10,000.00 €.
Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve - Zyra e Kryetarit (16018) vlera prej 17,000.00;
Administrata e arsimit (92090) vlera prej 3,000.00;
Në kategorinë e shpenzimeve kapitale- Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:
"Bashkëfinancim me donatorë, kodi (48267), shuma prej 300,000.00 €;
"Ndërtimi i stacionit të autobusëve", kodi (48112), shuma prej 63,000.00 €;
"Asfaltimi i rrugëve në infrastrukturën nëntokësore në Dresnik-Dolc", kodi (48121), shuma prej 150,000.00 €;
"Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë, kodi (49553), shuma prej 40,000.00 €;
"Asfaltimi i rrugëve lokale në Ranoc-Leskoc", kodi (49591), shuma prej 60,000.00 €;
"Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë-Paskalicë-Krushevë e Madhe, kodi (50662), shuma prej 20,000.00 €;
"Ndërtimi i Rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Drenoc", kodi (47156), shuma prej 40,000.00 E;
"Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë", kodi (49602), shuma prej 174987.61 €;
"Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes", kodi (49606), shuma prej 130,000.00 €;
"Rregullimi i shtratit të lumit Klina në drejtim të Grykës së Jarines", kodi (50683), shuma prej 100,000.00 €.
Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet: "Rregullimi dhe zgjerimi i parqeve në Klinë", kodi (52511), shuma prej 30,000.00 €;
"Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt në Resnik, Leskoc etj " kodi (52516), shuma prej 50,000.00 €;
"Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Zllakuqan-Jashanicë etj," kodi (52518), shuma prej 50,000.00 €.

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që kërkesa për bartje të mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit 2022 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për destinimin e parcelës Nr.00109-0 ZK. Dolc-Klinë për ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit.

Drejtori i DUMM, z. Enver Berisha, theksoi se kjo kërkesë për ridestinimin e parcelës nr.00109-0 Zk.Dolc-Klinë për ndërtimin e objektit për shtëpi të moshuarve, ju njoftojmë se komuna e Klinës ka për qëllim ndërtimin e objektit të shtëpisë për përkujdesje ndaj personave të moshuar, (shtëpi e të moshuarve), andaj për ndërtimin e objektit kemi menduar që të propozojmë ridestinimin e parcelës Nr.00109-0 Zk Dolc komuna Klinë, pronë shoqërore, shkolla fillore "Dostijev Obradoviq".

Kjo parcelë është e lirë dhe e përshtatshme për ndërtimin e objektit, pasi që objekti i shkollës së fshatit Dolc është i ndërtuar në një lokacion tjetër.

Parcela sipas Hartës Zonale ka kodin ZB2 (zonë banimi) dhe ka destinimin Banim Individual, mirëpo sipas HZ në përshkrim në pikën 5.1 në paragrafin shfrytëzimet e lejuara dytësore i

përfshin edhe shfrytëzimet me aktivitete sociale, po ashtu edhe në paragrafin shfrytëzimet e lejuara të veçanta përfshin edhe shërbimet shëndetësore.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga DUMM, për ridestinimin e parcelës për ndërtimin e shtëpisë për të moshuar, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin janar-shkurt 2023.

Kërkesa 1

Kërkesë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së për dhënie në shfrytëzim 20 ari tokë në kodrën e fshatit Gremnik, për vendosjen e tre shkronjave të UÇK-së dhe ndërtimin e parkut i cili do të emërohet parku i UÇK-së.

-Pas shqyrtimit të kërkesës në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe verifikimit të pronës së kërkuar nga OVL, u konstatua që vendi i kërkuar nga OVL nuk është pronë shoqërore e Komunes së Klinës, por pronë e pylltarisë Sharri, andaj Komiteti rekomandoi që Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së t'i drejtohet me kërkesë pronarit të parcelës, Pylltarisë Sharri. Ndërsa nëse është e nevojshme ndihma në forma të tjera, nga komuna do të ketë mbështetje.

Kërkesa 2.

Paraqitësja e kërkesës: N. (B.) G. nga Klina.
Si fillim me lejoni që t'ju falënderoj për ndihmën që me keni ofruar vazhdimisht dhe që vazhdoni të më ndihmoni akoma. Unë dhe fëmijët e mi ju jemi tejet mirënjohës Kryetarit, Nënkyetares dhe çdo personi tjetër që kontribuoj sado pak në zgjidhjen e problemit tonë për strehim të përkohshëm, në kohën kur unë si viktimë e dhunës në Familje më së shumti kisha nevojë. Mirëpo, me keqardhje duhet të ju njoftoj se përkundër përpjekjeve të mia për punësim apo vetëpunësim, nuk arrita të punësohem dhe në pamundësi të përmirësimit të gjendjes time ekonomike, po detyrohem t'ju drejtohem edhe njëherë ju si Kuvend për të më ndihmuar në pagesën e qirasë. Momentalisht unë me dy fëmijët e mi jemi duke jetuar në banesë me qira prej 250 euro, ku shuma të cilën me keni ndihmuar më parë nuk më mjafton për muajt në vazhdim. E si rezultat i kësaj ndihemi të rrezikuar se në këto ditë të ftohta do të mbesim pa strehë mbi kokë. Gjendja ime ekonomike është shumë e dobët.
Unë nuk kam pronë time të trashëguar apo çfarëdo qoftë tjetër mbi vete, jetoj në një gjendje të rëndë ekonomike, e çka më sjell edhe para sfidave të mëdha sociale.
Andaj unë N. G. kërkoi nga institucioni i lartocurur që të marrë parasysh kërkesën dhe nevojën time urgjente dhe të na bën një zgjidhje duke më ndihmuar financiarisht për strehim të përkohshëm deri në një zgjidhje definitive të një banimi.
Me përgjegjësi të lartë morale deklaroj se jetoj në kushte jo të mira ekonomike.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës nga N. G. nga Klina, për subvencionim të qirasë së banimit, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend.